



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruraina Savetodavna Služba Kosova



KOSOVA DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM
Address: Dishmorët e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com
www.kdc-ks.org

Të ushqyerit e gjedhit në faza të ndryshme të ciklit të prodhimit të qumështit



HYRJE

Për një prodhimtari të lartë qumështi duhet përmirësuar sistematikisht strategjitë e të ushqyerit, gjenetikën e tufës, efikasitetin e mjeljes, integrimin e teknologjisë dhe qëndrueshmërinë e fermës, duke reduktuar kostot e prodhimit dhe ndikimin në mjedis. Menaxhimi i mirë i shëndetit të kafshëve në fermë kërkon një qasje të integruar që përfshin ushqimin e balancuar, vaksinimin, kontrollin e parazitëve, higjienën e mirë dhe përdorimin e teknologjisë adekuate në fermë. Duke ndjekur këto masa, mund të arrihet prodhim i lartë, cilësi më e mirë e qumështit dhe mishit, si dhe reduktim i shpenzimeve për trajtime mjekësore.

Duhet vlerësuar nivelet aktuale të prodhimit të qumështit që janë cilësia e ushqimit, shëndeti i kafshëve dhe infrastruktura e fermës. Përcaktohen zonat ku ekzistojnë joefikasitete të prodhimit, të tilla si metodat e të ushqyerit, gjenetika e tufës ose procedurat e mjeljes. Sigurohet ushqim foragjer me cilësi të lartë (silazh, sanë), drithëra të pasura me energji (misër, elb) dhe shtojca proteinike (miell soje). Sigurohen nivele adekuate të vitaminave (A, D, E) dhe mineraleve (kalcium, fosfor, magnez) për prodhimin e qumështit.

Për një prodhimtari të lartë të qumështit, duhet përdor programin - softuerin e menaxhimit të ushqimit për të optimizuar racionet bazuar në produktivitetin e gjedheve dhe fazën e laktacionit.

Duhet siguruar ujë të pastër dhe të freskët gjatë gjithë kohës, pasi gjedheve qumështore u nevojiten 50-80 litra në ditë. Zgjidhen gjedhe me potencial të lartë të prodhimit të qumështit (p.sh., Holstein, Gjedhi i kuq danez, etj).

Përdoren teknikat e inseminimit artificial për të përmirësuar tiparet e dëshirueshme si rezistenca ndaj sëmundjeve dhe rendimenti i qumështit. Sigurohemi që gjedhet të rriten në kohën e duhur për cikle të vazhdueshme laktacioni. Largohen gjedhet me performancë të ulët ose jo të shëndetshme për të ruajtur produktivitetin e tufës.

Duhet mbajtur një rutinë të qëndrueshme mjeljeje (2 herë në ditë) për të maksimizuar rendimentin e qumështit. Përdoren makina mjelëse mekanike për të përmirësuar efikasitetin dhe higjienën. Dezinfektohet gjiri i gjedhit para dhe pas mjeljes për të parandaluar infeksionet. Testohet rregullisht qumështin për kontaminim bakterial, sasinë e qelizave somatike (SCC) dhe raportin yndyrë/proteinë. Përmirësohet shëndeti i kafshëve dhe kontrollet e sëmundjeve, si dhe kryhet vaksinimi dhe masat e biosigurisë për parandalimin e sëmundje si mastiti, sëmundjet Afta Epizootike dhe bruceleza.

Shëndeti i kafshëve është një faktor kyç për produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e fermave blegtorale. Menaxhimi i mirë i shëndetit të bagëtive ndihmon në rritjen e prodhimit të qumështit dhe mishit, reduktimin e shpenzimeve mjekësore dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve. Mastiti (infeksioni i gjirit) është një nga problemet më të zakonshme të gjedhet qumështore.

Për parandalimin e mastitit duhet pastrim i rregullt i gjinjve para dhe pas mjeljes, përdorimi i pecetave antiseptike pas çdo mjeljeje, mbajtja e stallave të pastra dhe të thata për të shmangur bakteret. Stallat e pastra dhe të ajrosura reduktojnë ndjeshëm rrezikun e sëmundjeve. Ventilim i mirë – ajrimi ndihmon në reduktimin e lagështisë dhe ndotësve të ajrit. Shtresa e pastër dhe e thatë parandalon infeksionet dhe stresin te kafshët, dhe pastrimi i rregullt i plehut parandalon përhapjen e baktereve dhe parazitëve.

MBAJTJA E TË DHËNAVE NË NJË FERMË TË GJEDHEVE PËR PRODHIM QUMËSHTI

Menaxhimi i saktë i të dhënave në një fermë qumështi është thelbësor për të monitoruar produktivitetin, shëndetin e gjedheve dhe për të optimizuar fitimet. Mbjajtja e të dhënave ndihmon fermerët të marrin vendime më të mira dhe të parandalojnë humbjet.

Mbjajtjen e Të Dhënave në Fermë mund të jetë si Regjistrimi Manual (Fletore ose Fletë Excel) ose përdorimi i programeve - Softuerëve për Fermat e Qumështit që ndihmojnë në regjistrimin dhe analizimin e të dhënave.



Figura 1. Regjistrimi i të dhënave për prodhimin dhe shëndetin e gjedheve

Të Dhënat e Identifikimit të Gjedheve

- Numri i gjedhit (etiketa e veshit)
- Raca dhe mosha
- Data e lindjes
- Origjina e kafshës (nëse është blerë apo lindur në fermë)

Të Dhënat e Prodhimit të Qumështit

- Sasia e qumështit të prodhuar për çdo gjedhe (matet çdo ditë)
- Cilësia e qumështit (yndyra, proteina, baktere, qeliza somatike)
- Ndryshimet sezonale në prodhim
- Koha e mjeljes (në mëngjes dhe në mbrëmje)

Të Dhënat e Shëndetit dhe Veterinarisë

- Vaksininimet dhe trajtimet mjekësore
- Kontrolli i mastitit dhe sëmundjeve të tjera
- Kontrolli i parazitëve të brendshëm dhe të jashtëm
- Problemet shëndetësore të mëparshme dhe trajtimi i tyre
- Data dhe rezultatet e analizave të qumështit

Të Dhënat e Riprodhimit

- Data e inseminimit ose mbarsjes natyrore
- Data e pritshme e lindjes
- Historia e riprodhimit (numri i pjelljeve, sukseset dhe dështimet)
- Statusi i fertilitetit të gjedheve
- Informacione mbi vëçat e lindur (peshë, gjinia, shëndeti)

Të Dhënat e Ushqyerjes dhe Konsumit të Ushqimit

- Lloji dhe sasia e ushqimit të konsumuar për gjedhe
- Shpenzimet për ushqimin e fermës
- Ndikimi i racionit në prodhimin e qumështit
- Racionet e ushqimit për grupmoshat e ndryshme të gjedheve

Të Dhënat Ekonomike dhe Financiare

- Kostoja e ushqimit, kujdesit veterinar dhe shpenzimeve të tjera
- Të ardhurat nga shitja e qumështit dhe produkteve të tjera (viça, pleh organik)
- Fitimi neto i fermës për periudha të caktuara
- Analiza e kthimit të investimit.

Tabela 1. Kërkesat e gjedhit për lëndë ushqyese për kg lëndë të thatë të racionit

Materiet Ushqyese	Tharja 60 – 21 ditë	Tharja 21 – pjellja	Faza e hershme e laktacionit	Faza e mesme e laktacionit	Fundi i laktacionit
Proteinat e përgjithshëm, %	12 - 13	13 - 15	17 - 18	16 - 17	15 - 16
Celuloza e përgjithshme, %	22	22	17	15	17
Yndyrat e përgjithshme, %	3-4	3-4	5-7	4-6	4-5
Kalciumi, %	0.50 – 0.70	0.60 – 0.75	0.80 – 1.00	0.80 – 0.90	0.70 – 0.80
Fosfori, %	0.30 – 0.35	0.30 – 0.35	0.45 – 0.55	0.45 – 0.50	0.40 – 0.45
Magnezi, %	0.20 – 0.25	0.22 – 0.24	0.28 – 0.35	0.25 – 0.30	0.22 – 0.28
Kaliumi, %	1.5	1.3	1.0 -1.5	1.0 -1.5	1.0 -1.5
Kripa, %	0.25 – 0.30	0.25 – 0.30	0.45 – 0.50	0.45 – 0.50	0.45 – 0.50
Ushqimi koncentruar, % LTH për racion	12 - 15	24 - 30	55 - 60	45 - 50	35 - 40
Vitamina A, IU/ditë	100.000	125.000	150.000	150.000	125.000
Vitamina D, IU/ditë	25.000	30.000	45.000	45.000	35.000
Vitamina E, IU/ditë	1.000	1.000	600 - 800	600 - 800	400 - 800

USHQIMI I GJEDHEVE QUMËSHTORE NGA THARJA DERI NË 14 DITË PARA PJELLJES

Çelësi i prodhimit të qumështit të suksesshëm dhe ekonomik në të ardhmen është ushqimi adekuat i gjedheve gjatë periudhës së pjellorisë. Ushqyerja e pamjaftueshme ndikon negativisht jo vetëm në peshën e lindjes së viçit, por edhe në rrjedhën e laktacionit të ardhshëm dhe në kohën e pjellorinë e radhës. Gjatë kësaj periudhe, gjedhet duhet të jenë tharë, zakonisht rreth dy muaj para pjelljes.

Një periudhë e thatë mjaft e gjatë ose ushqimi i pamjaftueshëm zvogëlon prodhimin e qumështit dhe të ardhurat nga gjedhet në laktacionin e ardhshëm deri në 30%. Rritja e nevojave është dukshëm më e madhe në muajin e nëntë se në muajin e tetë të pjellorisë së gjedheve. Nevojat për energji në dy muajt e fundit të pjellorisë janë rreth 30% më të larta se nevojat për mirëmbajtje. Nevoja për proteina rritet me 80%, kalcium me 60% dhe fosfor me 40%.

Para pjelljes, është e nevojshme të zvogëlohet përgjysmë sasia e ushqimit të koncentruar ose të eliminohet plotësisht. Për dy deri në tre ditë para pjelljes, dhe po aq ditë pas pjelljes, gjedhi ha pak. Pas kësaj, racioni ngadalë normalizohet, rritet gradualisht dhe në 10-14 ditë kafsha kalon në një racion të plotë, e cila plotëson nevojat e saj dietike dhe produktive. Është e nevojshme që gjedheve t'u sigurohet ushqimi i cilësisë më të mirë, si dhe ushqimi i koncentruar në sasinë e 1% të peshës trupore.

SKEMA E TË USHQYERIT TË GJEDHEVE QUMËSHTORE PAS PJELLJES

Skema e të ushqyerit të gjedheve qumështore pas pjelljes është thelbësore për të siguruar një prodhim optimal të qumështit, një rikuperim të shpejtë të gjedhit dhe një riprodhim të suksesshëm.

1. Faza e parë: 0-21 ditë pas pjelljes (periudha e tranzicionit)

Qëllimi i të ushqyerit cilësorë është rikuperimi pas pjelljes, rritja e konsumit të ushqimit dhe përgatitja për prodhim të lartë të qumështit. Synimi kryesor është të minimizohet stresi metabolik dhe të rritet konsumimi i ushqimit për të përballuar kërkesat e larta energjetike.

Si ushqim përdoren foragjere cilësore si bari i thatë, silazh misri, bar i gjelbër (nëse është i disponueshëm). Gjedhet ushqehen me koncentre me energji të lartë (18-20% proteinë e tretshme). Kalcium dhe Fosfor për të parandaluar hipokalceminë (furnizimi me kripëra kalciumi është i domosdoshëm), Magnez për të përmirësuar metabolizmin e energjisë, Vitamina A, D, E për shëndetin e sistemit imunitar dhe riprodhues dhe Majaja dhe probiotikët për të stabilizuar florën e zorrëve dhe rumenit.

Rritet gradualisht sasia e konsumit të ushqimit për të shmangur stresin metabolik. Monitorohet sasia e qumështit dhe kondicionit trupor për të vlerësuar nevojat ushqyese dhe sigurohet sasi e ujit të pastër dhe të bollshëm për të nxitur konsumimin e ushqimit.

2. Faza e dytë: 21-70 ditë pas pjelljes (piku i prodhimit të qumështit)

Kjo fazë është periudha kur gjedhi arrin nivelin më të lartë të prodhimit të qumështit. Ushqyerja e duhur në këtë periudhë është thelbësore për të ruajtur shëndetin e gjedhit, për të përballuar kërkesat e larta për energji dhe për të siguruar vazhdimësinë e prodhimit të qumështit. Synimi është të mbahen nivelet e energjisë dhe proteinave të balancuara për të ruajtur një prodhim të qëndrueshëm dhe të lartë.

Laktacioni rrit në mënyrë dramatike nevojat e gjedheve – një gjedhe që prodhon 30 kg qumësht ka nevoja për energji 3 herë më të larta se një gjedhe që është në periudhën e tharjes. Periudha më kritike është laktacioni i hershëm ku ka një rritje të shpejtë të prodhimit të qumështit dhe pas 6-8 javësh arrihet prodhimi maksimal, ndërsa konsumi maksimal i racionit arrihet vetëm pas javës së 10-të të laktacionit. Ndërsa laktacioni përparon, bëhet më e lehtë të plotësohen nevojat e gjedheve. Është e rëndësishme të krijohet një ekuilibër optimal midis sasisë, cilësisë dhe kohës së marrjes së ushqimit.

Ushqyerja e rekomanduar është foragjere me cilësi të lartë si silazh misri dhe sanë e pasur me proteinë (jonxha) që janë thelbësore për të siguruar energjinë dhe proteinat që kërkohen gjatë fazës me prodhim të lartë. Bari i gjelbër (nëse është i disponueshëm) mund të përdoret, por duhet kontrolluar për të shmangur acidozën. Bar i thatë është i dobishëm për të siguruar fibra të mjaftueshme që ndihmojnë në aktivitetin e rumenit.

Jepet ushqim të koncentruar me energji të lartë me 16-18% proteina për të siguruar një furnizim të mjaftueshëm proteinik për sintezën e qumështit. Grurë, misër, elb dhe drithëra të tjera përdoren për të siguruar energjinë e nevojshme, pasi kërkesat energjetike janë shumë të larta gjatë kësaj periudhe. Nëse prodhimi i qumështit të gjedhit është më i lartë, nevojiten sasi më të mëdha të ushqimit të koncentruar cilësor. Nëse sana është e cilësisë së mirë, nevojat ditore të gjedheve janë 2 kg për 100 kg peshë trupore. Sasia e silazhit të misrit në racion mund të jetë 8 kg për 100 kg peshë trupore. Në llogaritje, 1 kg sanë jonxhe është e barabartë në vlerë me 2-2,5 kg silazh misri.

Jepet kalcium dhe fosfor për të mbështetur prodhimin e qumështit dhe për të parandaluar hipokalceminë, magnez për të ndihmuar metabolizmin dhe funksionimin e muskujve dhe nervave, vitaminat A, D, E për të mbështetur shëndetin e sistemit imunitar dhe riprodhues si dhe vitaminë C për mbrojtjen nga stresi oksidativ që lidhet me prodhimin e qumështit në nivele të larta. Për përmirësimin e tretjes dhe shëndetit ruminal jepen probiotikët dhe majaja e bikarbonat natriumi mund të përdoret për të rregulluar pH-në e rumenit dhe për të parandaluar acidozën.

Gjatë verës, është e rëndësishme që gjedhet të kenë një mjedis të freskët dhe të pastër për të parandaluar humbjen e konsumit të ushqimit dhe probleme të tjera shëndetësore. Kjo periudhë është shumë kërkuese për gjedhen, ndaj është e rëndësishme të sigurohet një racion i pasur dhe e balancuar që mundëson prodhim optimal të qumështit.

Faza e tretë: 70-150 ditë pas pjelljes (Stabilizimi i prodhimit të qumështit)

Kjo është periudha kur është e rëndësishme të mbahet nën kontroll humbja e peshës trupore dhe të sigurohemi që gjedhi të vazhdojë të prodhojë qumësht në nivele të qëndrueshme. Pas një periudhe të lartë prodhimi, duhet të rregullohet racioni për të siguruar që gjedhi të ketë mjaftueshëm energji dhe proteina pa shkaktuar rritje të peshës trupore. Uji i pastër është i nevojshëm për të mbështetur proceset metabolike dhe prodhimin e qumështit. Ushqimi duhet të jetë i balancuar për të mbështetur periudhën e riprodhimit dhe për të siguruar shëndetin riprodhues të gjedhit.

Në këtë periudhë, gjedhet duhet të ndihmohen për të stabilizuar prodhimin e qumështit dhe për të rikuperuar energjinë e humbur gjatë fazës së pikut të prodhimit. Ushqimi duhet të mbështesë rikuperimin e trupit dhe përgatitjen për riprodhimin, duke parandaluar gjithashtu humbjen e peshës trupore.

Ushqyerja duhet të përqendrohet në ruajtjen e një prodhimi të qëndrueshëm të qumështit, mbështetjen e rikuperimit të trupit, dhe përgatitjen për periudhën e ardhshme të riprodhimit. Kjo është një periudhë kur konsumi i ushqimit mund të fillojë të zvogëlohet, ndaj menaxhimi i racionit është thelbësor për të parandaluar humbjen e peshës trupore dhe për të ruajtur shëndetin e përgjithshëm.

Ushqyerja e rekomanduar janë foragjeret cilësore si silazh misri dhe jonxhe për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm me energji dhe proteina, bar i thatë me nivel të moderuar të fibrave, për të ndihmuar në aktivitetin e rumenit dhe për të parandaluar acidozën ruminale dhe sanë e pasur me proteinë dhe bar i gjelbër mund të përdoren, por në sasi të kontrolluara për të ruajtur balancën energjetike.

Përdoret ushqim i koncentruar me 15-16% proteinë për të mbështetur prodhimin e qumështit dhe rikuperimin e trupit të gjedhit, drithëra si misër, elb dhe grurë për energji të qëndrueshme dhe për të shmangur rënien e peshës trupore dhe yndyra (fat bypass) për të rritur balancën energjetike pa rrezikuar acidozën ruminale.

Shtesa minerale dhe vitamina përfshijnë kalcium dhe fosfor për të mbajtur një balancë të shëndetshme të mineraleve dhe për të parandaluar çrregullimet metabolike, magnez dhe vitamina D për të mbështetur funksionin metabolik dhe për të siguruar një sistem riprodhues të shëndetshëm si dhe vitaminat A dhe E për shëndetin imunitar dhe për mbështetje ndaj procesit riprodhues.

Si shtesa të nevojshme janë probiotikët dhe majaja për të ruajtur florën ruminale të shëndetshme dhe për të përmirësuar tretjen e ushqimit, bikarbonat natriumi mund të përdoret për të mbajtur pH-në e rumenit në nivele të shëndetshme dhe për të parandaluar probleme si acidoza dhe omega-3 që mund të përmirësojnë cilësinë e qumështit dhe të mbështesin shëndetin e përgjithshëm të gjedhit.

Faza e katërt: 150-305 ditë pas pjelljes (Rënia e prodhimit të qumështit dhe përgatitja për tharje)

Faza e katërt është periudha e stabilizimit të prodhimit dhe përgatitjes për tharje, e cila është shumë e rëndësishme për shëndetin e gjedhit dhe përgatitjen për riprodhimin e ardhshëm. Ushqyerja duhet të jetë e ekuilibruar dhe e kontrolluar për të mbështetur shëndetin dhe për të parandaluar çrregullimet metabolike.

Në këtë periudhë, prodhimi i qumështit fillon të bie, dhe qëllimi kryesor është të stabilizohet dhe të përgatitet gjedhi për periudhën e tharjes, e cila është një fazë e rëndësishme për riprodhimin dhe rifillimin e laktacionit të ardhshëm. Ushqyerja duhet të fokusohet në ruajtjen e kondicionit trupor të gjedhit dhe sigurimin e një racioni që mbështet shëndetin e përgjithshëm dhe rikuperimin e trupit.

Objektivat kryesore janë ruajtja e kondicionit trupor dhe parandalimi i dhjamosjes para tharjes, stabilizimi i prodhimit të qumështit dhe mbështetje e shëndetit të gjedhit, si dhe përgatitja për periudhën e tharjes dhe laktacionin e ardhshëm.

Ushqyerja e rekomanduar janë foragjere cilësore dhe me sasi të moderuar si silazh misri dhe jonxhe, pasi energjia dhe proteina janë më të ulëta gjatë kësaj periudhe. Bari i thatë (me nivel të moderuar të fibrave) ndihmon në stabilizimin e përbërjes trupore dhe ndihmon rumenin të funksionojë normalisht.

Sanë e pasur me proteina mund të përdoret, por duhet kontrolluar për të parandaluar mbiprodhimin e proteinave dhe dhjamosjen.



Përdoret ushqim i koncentruar me 14-16% proteina për të mbështetur shëndetin e gjedhit, por pa shkaktuar mbiprodhim të qumështit ose dhjamosje të trupit si dhe grurë, misër dhe elb për energji të moderuar dhe për të mbajtur gjedhi të shëndetshme pa rritur shumë peshën trupore. Gjithashtu përdoret kalcium dhe fosfor për shëndetin e skeletit dhe për të mbajtur ekuilibrin mineral, magnez për metabolizmin dhe për të ndihmuar muskujt dhe nervat, vitaminat A, D dhe E që mbështesin shëndetin riprodhues dhe imunitar, të cilat janë të rëndësishme për periudhën e tharjes dhe përgatitjen për riprodhim.

Përgatitja për tharje dhe periudhën e ardhshme të laktacionit bazohet në reduktimin gradual të ushqimeve të koncentruar dhe ulja e sasive të energjisë për të parandaluar prodhimin e tepërt të qumështit dhe për të përgatitur trupin e gjedhit për tharje.

Faza e pestë: Të ushqyerit e gjedheve gjatë periudhës së tharjes

Të ushqyerit zakonisht shprehet për gjedh, në bazë të lëndës së thatë (LTH) për një periudhe 24-orëshe. Gjatë përgatitjes së racionit, është e nevojshme të njihet ose të parashikohet me sukses LTH dhe të rregullohet përbërja e racionit në përputhje me nevojat e kafshëve. Nëse cilësia dhe sasia e ushqimit që konsumojnë gjedhet nuk është e koordinuara me njëra-tjetrën, ndodh humbje e tepërt e peshës ose trashje e kafshëve, e cila rezulton në shfaqjen e çrregullimeve metabolike dhe riprodhuese.

Gjedhet mund të ushqehen vetëm me foragjere të gjelbra të cilësisë së mirë dhe me 1-2 kg koncentrat. Racioni duhet të ketë densitet të moderuar të energjisë me nivele të ulëta proteinash (12 deri në 14 %) dhe amidon (12 deri në 16 %).

Tabela 2. Konsumimi i ushqimit në fazat e ndryshme të prodhimit të gjedhit

Faza e ciklit të prodhimit	Konsumimi i ushqimit në Kg (lënda e thate)
Java e parë e laktacionit	14
Muaji i tretë i laktacionit	24
Mesi i laktacionit	21
Fundi i laktacionit	18
Faza e parë e tharjes	12
Faza e dytë e tharjes	10

Tabela 3. Të ushqyerjes e gjedhit gjatë fazave të ndryshme të prodhimit të qumështit

Kërkesat e gjedheve	0-21 ditë (Periudha kalimtare)	21-70 ditë (Prodhimi maksimal)	70-150 ditë (Stabilizimi i prodhimit)	150-305 ditë (ulja e prodhimit të qumështit dhe tharja)
Kërkesat për energji	E lartë (për të mbështetur prodhimin dhe rikuperimin e qumështit)	Shumë e lartë (prodhimi maksimal i qumështit)	E moderuar (prodhimi i qumështit fillon të bjerë)	E ulët deri në mesatare (përgatitje për tharje)
Kërkesat për proteina	E lartë (për të mbështetur prodhimin dhe rikuperimin)	E lartë (për të ruajtur prodhimin e qumështit)	E moderuar (prodhimi i qëndrueshëm)	E ulët deri në mesatare (përgatitja për tharje)
Kërkesat e fibrave	E moderuar (për të ruajtur shëndetin e rumenit)	E moderuar (për të ruajtur shëndetin e rumenit)	I lartë (parandalimi acidozës ruminale, mbështetë tretjen)	E lartë (për marrjen e fibrave dhe mirëmbajtjen e gjendjes së trupit)
Foragjere (silazh dhe sanë)	Silazh me cilësi të lartë (jonxhë, misër, etj.)	Silazh dhe sanë me cilësi të lartë (të pasura me fibra)	Foragjere me cilësi të moderuar (silazh, bar)	Foragjere me cilësi të mirë (sanë dhe silazh)
Koncentrat et	E moderuar në të lartë (për të mbështetur laktacionin)	E lartë (për të mbështetur prodhimin maksimal të qumështit)	E moderuar (për të mbështetur prodhimin e qëndrueshëm të qumështit)	E ulët (për t'u përgatitur për tharje)
Kërkesat për yndyrë	E moderuar (marrja e ekuilibruar e yndyrës për energji)	Mesatarisht në të lartë (për energji shtesë)	E moderuar (për të parandaluar shtimin e tepërt të peshës)	E ulët deri në mesatare (parandalimi grumbullimit të yndyrës)
Mineralet & Vitaminat	I lartë (kalcium, fosfor, vitaminë D për rikuperim)	E lartë (për prodhimin e qumështit dhe metabolizmin)	E moderuar (mbështetjen e kockave dhe metabolizmit)	E ulët deri në mesatare (përgatitja për tharje)
Marrja e ujit	Shumë e lartë (e domosdoshme për prodhimin e qumështit)	Shumë e lartë (kërkesat për prodhimin e qumështit)	E lartë (për të ruajtur hidratimin)	E lartë (e nevojshme për qumësht dhe përgatitje për tharje)

Për më shumë informata ju lutem kontaktoni:

MBPZHR- Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike

Rr. "Ukshin Hoti" ndërtesa "Ramiz Sadiku", Nr.120

10000 Prishtinë

Tel : +383 38212338 ; +383 200 38 426

Tel/ fax: +383212 987

Kjo broshurë është përgatitur nga KDC, me Projektin "Zhvillimi i Zonave Rurale përmes avancimit të Shërbimeve Këshillimore", të financuar nga MBPZHR. Përgjegjësinë për përmbajtjen e broshurave e mban KDC.



**KOSOVA DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM**

Address: Dëshmorët e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë

Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com

www.kdc-ks.org